



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike/Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost
Kosovo Academy for Public Safety

AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE

Fakulteti i Sigurisë Publike

shpall

K O N K U R S

Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve, për vitin akademik 2018 - 2019

Akademia e Kosovës për Siguri Publike - Fakulteti i Sigurisë Publike, në vitin e parë të studimeve, për vitin akademik **2018/2019** do të regjistrojë 65 studentë nga Institucionet e Sigurisë Publike, sipas kuotës së përcaktuar në drejtimet e programit të studimit bachelor në sigurinë publike, si vijon:

I. DREJTIMI DOGANOR

Dogana e Kosovës 4 studentë në nivel institucioni;

II. DREJTIMI MENAXHIMI EMERGJENT

Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave 7 studentë në nivel institucioni;

KUSHTET E KONKURSIT

Në konkurs mund të paraqiten kandidatë të cilët i plotësojnë këto kushte:

1. Të kenë të përfunduar me sukses shkollimin e mesëm të vërtetuar me diplomë;
2. Të jenë të punësuar në Institucionet e Sigurisë Publike, respektivisht në:
 - 2.1 Doganën e Kosovës si zyrtar doganor;
 - 2.2 Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave të Kosovës;
3. Të kenë se paku tre (3) vite përvojë pune në agjencitë përkatëse të sigurisë publike;

Kandidatët mund të konkurrojnë vetëm në drejtimin e studimit sipas institucionit punëdhënës.

Aplikimi bëhet online në adresën elektronike <http://smu.aksp-ks.net:8090/>

Formulari i aplikimit i plotësuar online përmes sistemit SMU të printohet dhe të dorëzohet së bashku me dokumentet në kopje fizike si vijon :

- Ekstraktin e lindjes, jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj;
- Kopjen e kartelës identifikuese të punës;
- Diplomën e shkollës së mesme në kopje të noterizuar.
- Vendimin mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit.
- Kontratën e punës e cila dëshmon marrëdhënien e punës në ndonjërin nga agjencitë e sigurisë publike (nëse kontrata është e lidhur brenda 3 viteve të fundit, aplikuesit duhet sjellin edhe kontratën paraprake që dëshmon përvojën e punës 3 vjeçare, kopje);
- Kontrata e lidhur me institucionin punëdhënës në mënyrë që pas përfundimit të fakultetit, zyrtari të shërbej në Institucionin punëdhënës së paku gjashtë (6) vite – rikthimi i investimeve. *(Kërkohet vetëm për kandidatët të cilët pranohen në programin bachelor, me rastin e regjistrimit të vitit akademik).*

Dokumentet duhet të dorëzohen në kopje fizike të noterizuara në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri, në **Objektin e ri Fakulteti i Sigurisë Publike Nr. i Zyrës 111**.

MENYRA E STUDIMIT

Për studentet që vijojnë studimet në programin bachelor në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, mënyra e studimit do të jetë si në vijim:

- Pjesa teorike (ligjëratat) vijohet në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike gjatë tri (3) ditëve të punës brenda javës, në ditët e hënë e martë dhe e mërkurë.
- Pjesa praktike (Internshipi) vijohet pas përfundimit të ligjëratave, më së largu deri më 30 shtator të çdo viti përkatës akademik në vendet e caktuara të punës në institucionet përkatëse konformë plan programit mësimor.

Studimet bachelor për pjesëtarët e agjencive të sigurisë publike ofrohen falas dhe pa shpërblye nga puna.

AFATET E KONKURSIT

Paraqitja e dokumenteve bëhet prej datës 17.09.2018 deri më 24.09.2018 në ora 16:00.

Provimi pranues do të mbahet në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri, më 25.09.2018 duke filluar prej orës 10.00.

Lidhur me provimin pranues kandidatet mund të referohen në Manualin për Përgatitjen e Provimit Pranues, të cilin mund ta shkarkoni në ueb faqen e Akademisë aksp.rks-gov.net

Kandidatët të cilët i nënshtrohen provimit pranues duhet të kenë me vete një dokument të identifikimit.

Shpallja e rezultateve preliminare të provimit pranues do të bëhet me datën **25.09.2018**, në ueb faqen e Akademisë aksp.rks-gov.net

Kandidatët të cilët nuk pranohen në vitin e parë të studimeve mund të paraqesin ankesë pran Komisionit të Ankesave në AKSP, më së largu deri me datën **28.09.2018**.

“Akademia e Kosovës për Siguri Publike ofron mundësi të barabarta të studimit për të gjithë pjesëtarët e agjencive të sigurisë publike dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë femërore dhe mashkullore përfshirë të gjitha komunitetet në Kosovë”.

Për informata me të hollësishme mund të kontaktoni Zyrën e Shërbimeve Studentore në numrin e tel:**028 590 070 ext 323** ose **326**, çdo ditë prej orës **08:00 – 16:00**.